

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Sot më datë **14/05/2024** në Tiranë në selinë e përcaktuar për zhvillimin e aktivitetit ndodhur në adresën: Rruga "Bardhyl", Pall. "Progeen", Kati 3, Apartamenti.8, Tiranë.

- **Aurent Pasha** i dtl 31/05/1980 me kartë ID Nr. **I00531042P**

Mbështetur në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" nr. 9901, datë 14.04.2008 Pjesa IV nenet 68-104, bien dakord dhe përcaktojnë si vijon:

NENI 1

"PASHA LEGAL SERVICES" themelohet nga i sipërcituari si Shoqëri e me përgjegjësi të kufizuar bazuar në dispozitat 1074-1112 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria **"PASHA LEGAL SERVICES"** shpik gëzon statusin e Personit Juridik Shqiptar dhe si e tillë në respektim të Ligjit nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" fiton personalitet juridik e për pasojë do fillojë aktivitetin pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe në organet tatimore.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pa kufizuar.

NENI 2

Aktiviteti i Shoqërisë bazohet në standartet e këtij Akti Themelimi, Statusit të Shoqërisë, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria.

NENI 3

Kapitali Themeltar i Shoqërisë së Thjeshtë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 1000 (njëmijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga Anëtarët Themelues në këtë mënyrë:

1. **Aurent Pasha** në masën 100 % të vlerës së kapitalit themeltar.

Vlerësimi i kapitalit themeltar është bërë nga anëtarët themelues, me rastin e themelimit të kësaj kontrate themelimit dhe është nënshkruar prej tij.

NENI 4

Shoqëria **"PASHA LEGAL SERVICES"**, ka për objekt të veprimtarisë së saj aktivitetet e mëposhtme:

- (a) Konsulencë ligjore dhe asistencë për personat juridike dhe fizikë në fushën e falimentimit, tregtare/financiare, civile, administrative, penale, familjare, marrëdhënies së punës, çështjeve

institucionale, e drejta e autorit, lirive dhe të drejtave të njeriut.

- (b) Konsulencë dhe informacion biznesi, konsulencë për shoqëritë tregtare, të cila kanë lidhje me çështjet organizative, administrimin e biznesit, menaxhimin, marketingun, konsulencë për taksat dhe tatimet si dhe planifikimin e përgjithshëm të tyre, burimet njerëzore dhe konsulencë të përgjithshme për shoqëritë që veprojnë në sektorët e biznesit dhe të industrisë, brenda kufizimeve të parashikuara në ligj.
- (c) Konsulencë mbi pajtueshmërinë rregullatore, ristrukturimi i borxhit, ristrukturim financiar, rishikimi dhe hartimi i kontratave, mbrojtja e asetëve, mbrojtja e të drejtave të konsumatorit, detyrat fiduciare, etj.
- (d) Konsulencë për administrimin, shitblerjen, dhënien me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të veprave civile, tregtare, industriale, publike apo private duke përfshirë pa u kufizuar në:
- ndërmjetësim për kryerjen e veprimeve të mësipërme midis personave juridikë privat apo publik, vendas apo të huaj dhe personave fizik, marketing, ekspertizë shitje,
 - vlerësim pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme,
 - zhvillimi dhe financimi i pasurive të paluajtshme,
 - vlerësimi i tatimit mbi pronën, ndërmjetësim,
 - përfaqësim për çështjen gjyqësore në gjykatë dhe menaxhim prone.
- Kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që ka lidhje të drejtëpërdrejtë ose jo me permbushjen e objektit të sipër përmendur të shoqërisë.

- (e) Në fushen e Biznesit: Aktivitete krijimi, Trajnime, dhe zhvillimi të mundësive të reja të biznesit midis Shqiperisë dhe shteteve të tjera. Aktivitete krijimi, Trajnime dhe krijime të aktiviteteve që kontribuojnë në zhvillimin e investimeve, si dhe punësimin në Shqipëri nga investitorë kombëtarë dhe të huaj. Shoqëria me qëllimin për të promovuar, imazhin e saj në të gjithë territorin kombëtar dhe jashtë saj, mund të ndërrmarë të gjitha iniciativat, të cilat janë të përshtatshme të tilla si: regjistrimin e markave apo të patentave; kurse formimi dhe azhurnimi profesional; krijimit, botimit, përhapjes, shpërndarjes dhe shitjes së librave, revistave apo të ngjashëm në sektorët e lartë përmendura.

- (f) Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

NENI 5

Për permbushjen e objektit të veprimtarisë së saj Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në lek apo në valuta të tjera pranë Bankave të nivelit të dytë, duke pasur kështu të drejtën e disponimit lirisht të mjeteve monetare të akumuluar në to, duke respektuar në çdo rast legjislacionin në fuqi.

NENI 6

Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis anëtarëve themelues. Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit Shqiptar.

NENI 7:

Anëtarët Themelues kanë këto detyrime:

- Të regjistrojë Shoqërinë pranë QKB;
- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë;
- Të sigurojë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme, etj;
- Të sigurojë mundësitë e specializimit të pandërprerë të personelit ndihmës së asistentëve gjithë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë të veprimtarisë së ushtruar nga ana e Shoqërisë;
- Të menaxhojë marketingun dhe reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

NENI 8

Shoqëria **“PASHA LEGAL SERVICES”** ka të drejtë që të çelë degë/filiale si dhe zyra përfaqësimi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, veprim për të cilin do të nevojitet vendimi i Asamblesë së ortakëve të shoqërisë me shumicë absolute.

NENI 9

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Anëtarëve.
2. Administratorët e Shoqërisë.

Mënyra e veprimtarisë së tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 10

Anëtarët themelues si dhe të gjithë anëtarët që do të pranohen si të tillë pranë shoqërisë duke përfshirë edhe bashkëpunëtorët e saj detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë.

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me menaxhimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen që të zhduajnë shoqërinë për dëmet që I janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Në rast mosmarrëveshjes që lindin për këtë akt themelimi do të zgjidhen nga vetë anëtarët themelues me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga Gjykatat kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëvedhjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Kontrata pasi u lexua nga Anëtarët Themelues u nënshkrua prej tyre.

ANËTARËT THEMELUES

AURENT PASHA

Aurent Pasha
